



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 5444 . Prot.

Shkodër , më 13.04.2020

VENDIM

Nr. 92 Datë 13.04.2020

**"PËR MARRJEN E MASAVE SHITESË PËR KUFIZIMIN, MONITORIMIN DHE
KONTROLLIN E LËVIZJEVE TË AUTORIZUARA TË TË GJITHË
QYTETARËVE NË QYTETIN E SHKODRËS"**

Në mbështetje të ligjit "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen Civile", në mbështetje të VKM nr. 965, datë 02.12.2016 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencës civile dhe krizave", në mbështetje të VKM nr. 243, datë 24.03.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", në zbatim të Urdhërit nr. 253, datë 18.03.2020 "Për ngritjen e komisionit të mbrojtjes civile në Bashkinë Shkodër", në kuadër të parandalimit të pasojave dhe përhapjes së COVID - 19,

VENDOSA

1. Marrjen e masave shtesë për kufizimin, monitorimin dhe kontrollin e lëvizjeve të autorizuara të të gjithë qytetarëve në qytetin e Shkodrës dhe në Njësitë Administrative:

A. Në tregun pranë Merkatës së Rusit.

Duke filluar që nesër, datë 14.04.2020, në treg do të tregëtojnë sipas radhës më poshtë:

1. Një ditë tregëtarët që kanë kontratë për hapësirë tregëtimit të shënuar me numër çift dhe ditën tjetër tregëtarët që kanë kontratë për hapësirë tregëtimit të shënuar me numër tek.

2. U kërkohet të gjithë tregëtareve të mos ekspozojnë mallrat dhe produktet ushqimore dhe industriale jashtë dyqaneve, në hapësirën publike.

B. Në tregun Zdrale

1. Ndalohet tregëtimi dhe hapja e tregut për një periudhë dy - javore, për subjektet që shesin me pakicë dhe në shumicë në këtë treg. kërkohet lirimi i hapësirës publike për një periudhë dy javore.

C. Të gjithë subjekteve tregëtare në Shkodër u kërkohet:

- Respektimi i masave higjieno-sanitare të shitjes së produkteve ushqimore dhe të tjera në ambientet e tregëtimit.
- Marrja e mbrojtëse shtesë për punonjësit që shërbejnë për klientët.
- Përmirësimi i vijëzimit dhe sinjalistikës për mbajtjen e radhës dhe distancës së duhur fizike orientuese për klientët.
- Ndalohet ekspozimi i produkteve ushqimore dhe industriale jashtë dyqaneve, në hapësirën publike.

D. Të gjitha subjektet, bare dhe restorante, aktualisht të mbyllura në respektim të masave kufizuese, u kërkohet që sot, brenda ditës, të lirojnë hapësirën publike në përdorim, të largojnë të gjithë karriget dhe mjetet të tjera.

E. Të gjithë banorëve të Bashkisë Shkodër u kërkohet marrja e masave shtesë për respektimin e distancës fizike, marrjen e masave shtesë për mbrojtjen vejake dhe të familjes me maska dhe doreza gjatë lëvizjës së autorizuar për kryerjen e shërbimeve për familjen.

F. Të gjithë banorëve u kërkohet të pajisen me autorizimin përkatës dhe vetëm për të kryer shërbimet e blerjet e domosdoshme për familjen.

G. Në rast mos zbatimi të këtij vendimi Bashkia Shkodër do të veprojë me masat administrative përkatëse.

H. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

